



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. 49 /22
Datë 16.11.2022

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës mbështetur në nenin 4, 5, 28, 29 dhe nenin 54, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229; dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës; neni 5, 6, paragrafi 3.5, neni 26, 27, 55 dhe neni 56 paragrafët 3 dhe 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056; Udhëzimi Administrativ për Përjashtim të Marrëveshjeve Horizontale Nr. 02/2017; Udhëzimi Administrative Nr. 05/2017 Për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve; si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas kërkesës së Kompanive të Sigurimit “Elsig” dhe “Eurosig” për përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes horizontale, në mbledhjen e mbajtur me datën 16.11.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. REFUZOHET kërkesa për përjashtim nga ndalimi i përgjithshëm i Marrëveshjes horizontale ndërmjet kompanive të sigurimit “Elsig” dhe “Eurosig” lidhur me marrëdhënien e tyre të bashkëpunimit me qëllim fiksimit e çmimit të policave të sigurimit për produktet bujqësore.
- II. Konstatohet, se marrëveshjet e përgjithshme për caktimin/fiksimit e çmimit, ndërmjet ndërmarrjeve të nivelit horizontal, janë shkelje sipas objektit (*per se*) dhe si të tilla bien ndesh me nenin 4 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim Ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-226 dhe neni 5 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Arsyetim

Më datë 20.06.2022 Autoriteti ka pranuar Kërkesën me Nr. Prot. 173/22-01/H për Përjashtim Marrëveshjes sipas Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për sigurimet bujqësore, nga Kompania e Sigurimeve EUROSIG sh.a.

Më datë 07.07.2022 Autoriteti ka pranuar Kërkesën me Nr. Prot. 191/22-01/H për Përjashtim të Marrëveshjes sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për sigurimet bujqësore, nga Kompania e Sigurimeve ELSIG sh.a.

Lënda e pranuar më datë 20.06.2022 të cilën Autoriteti e ka pranuar sipas kërkesës me Nr. Prot. 173/22-01/H është trajtuar sipas Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për efekt që të jetë besnike me legjislacionin në fuqi në momentin e pranimit të saj.

Ndërkaq, lënda e pranuar me datë 07.07.2022 të cilën Autoriteti e ka pranuar sipas kërkesës me Nr. Prot. 191/22-01/H për Përjashtim të Marrëveshjes sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, është trajtuar me të njëjtin për efekt që të jetë besnike me legjislacionin në fuqi në momentin e pranimit të saj.

Kërkesa për Përjashtim nga Marrëveshjet Horizontale nga Kompanitë e Sigurimeve me qëllimin e fiksimit të çmimeve të produktit “**Sigurimi i produkteve bujqësore**”.

Objekt i marrëveshjes sipas kërkesës së palëve

Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve të sigurimit, lidhur me tregun e produktit, sigurimi i produkteve bujqësore për mbulimin e primeve të sigurimit 75% nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe 25% nga fermerët dhe Kërkesa për Përjashtim nga Marrëveshjet Horizontale, për kompanitë e sigurimeve me qëllim fiksimit të çmimit të produktit - Primeve (*Sigurimi i produkteve bujqësore*). Çmimet për produkte të njëjta bujqësore, bëhen konform produkteve standarde bujqësore, të cilat miratohen nga MBPZHR çdo fillim apo fund vit. Produktet - skemat e dizajnuara për sigurimin bujqësorë nga MBPZHR dhe IFC (këshillues i projektit) deri më tani janë produktet të tipit indeks: mollë, boronicë, qershi, misër, fasule, dardhë, spec, kumbulla, mjedër, vishnje, dredhëz, arrë, rrush dhe sigurimit tradicional bujqësor tek kultura e mollës, specit dhe rrushi i verës.

Kulturat bujqësore të zgjedhura për subvencionim të Primit të sigurimit kultivohen në sipërfaqe më të mëdha në krahasim me kulturat e tjera, përkatësisht në vitin 2020: me mollë 3,068 ha, kumbull 2,201 ha, mjedër 1,661 ha, dredhëz 236, rrush për verë 3,447 ha, spec 3,134 ha, arra 1,295 ha, fasule 377 ha misri 39,684 ha, dardha 614 ha, qershi 108 ha, vishnje 233 ha.

Për të gjithë fermerët, të cilët bëjnë blerjen e policave të sigurimit bujqësorë (*indeks ose tradicional*) MBPZHR, ka bërë subvencionimin e primit, fillimisht në vlerën 50%, në vitin e kaluar 75%, dhe këtë vit përsëri në vlerën e 75%. Ky subvencionim është bërë sipas kushteve dhe kriterëve të cilat ka përcaktuar MBPZHR, përmes miratimit dhe shpalljes së Programit të Pagesave Direkte, në përputhje me legjislacionin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Sigurimet bujqësore paraqesin një formë të menaxhimit të rrezikut që shfrytëzohet si mbrojtje nga humbjet potenciale duke u ofruar fermerëve mundësinë e kompensimit në rast të ngjarjeve të motit. Sigurimi bujqësor ofron mbrojtjen nga humbjet dhe dëmet e kulturave bujqësore. Përveç kësaj, sigurimi bujqësorë paraqet një mjet të rëndësishëm për të zbutur rreziqet dhe për të siguruar rrugë më të sigurt për investimet e bankës.

Duke pasur parasysh rreziqet, që ka ky produkt kompanitë e sigurimit kanë arritur të lidhin marrëveshje me vetëm një Ri-sigurues për shkak të hezitimit të Ri-siguruesve tjerë për arsye të rreziqeve të mëdha që paraqet marrja përsipër e këtij produkti.

- Që nga fillimi i projektit, kompania e Sigurimeve ELSIG, ka ofruar për shitje dhe ka realizuar policat e sigurimit bujqësorë.

Andaj, palët kanë parashtruar kërkesë, pranë Autoritetit, për vlerësim lidhur me përjashtimin nga Ndalimi tek Marrëveshjet Horizontale, bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-229, dhe Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në mes të kompanive të sigurimit, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me çmimin apo kushtet tjera ndërmjet kompanive të sigurimit për ofrimin e primeve të sigurimit bujqësorë për kulturat e lartë-cekura. Kjo kërkohet që të konsiderohet si valide për përjashtim nga marrëveshja horizontale sipas nenit 5 të ligjit të lartpërmendur, për faktin që MBPZHR është pajtuar që të paguaj 75% të primeve të sigurimeve bujqësore dhe pjesa tjetër 25% e primeve do të paguhet nga fermeri, ndërkaq, kompanitë e sigurimit do të ofrojnë kushte të njëjta për të gjithë fermerët për produktet e njëjta - produktet standarde të miratuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

- ANALIZA E KONKURRENCËS

Për të vlerësuar çështjet e konkurrencës, fillimisht janë analizuar parametrat e tregut përkatës, bazuar në, U.A Nr.02/2018 për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, si në vijim:

Tregu relevant

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit - Sigurimi i Primit, për Produkte bujqësore nga Kompanitë e sigurimeve licencuara nga Banka Qendrore.

Autoriteti i Konkurrencës, ka filluar me trajtimin e rastit sipas kërkesës së palëve, si në vijim:

- Ndërmarrja, kompania e sigurimeve, “Elsig”, sh.a
- Ndërmarrja, kompania e sigurimeve “Eurosig”, sh.a

Kërkesa e Kompanive të Sigurimit “ELSIG” dhe “EUROSIG” për përjashtim nga marrëveshja horizontale, nuk i plotëson kushtet për tu lejuar, nga Autoriteti.

Për lejimin e një përjashtim nga marrëveshja horizontale, AKK është bazuar në Legjislacionin primar dhe sekondar si:

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-226, dhe Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht, Udhëzimi Administrativ për Përjashtim të Marrëveshjeve Horizontale Nr. 02/2017, me asnjë dispozitë nuk e lejon fiksimin e çmimit respektivisht Primit.

Marrëveshjet në të cilat nuk zbatohet përjashtimi grupor sipas nenit 4 të U.A Nr. 02/2017, në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ nuk mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm po ashtu bazuar në neni 4, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe neni 5 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-056.

- Marrëveshjet horizontale që nuk janë të harmonizuara me këtë Udhëzim Administrativ, si më lartë,
- Marrëveshjet horizontale në të cilat nuk zbatohen rregulla tjera për përjashtim grupor nga neni 5, dhe 7A paragrafi 2 i Plotësim ndryshimit të ligjit Nr.04/L-226.

Ligji për Mbrojtjen Konkurrencës është i harmonizuar me traktatet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian-TFBE, Neni 101(3) në thelb përcakton të njëjtat kushte dhe kritere prandaj, për vlerësimin e kërkesave për përjashtime, Autoriteti i Konkurrencës bazuar në nenin 66 të LMK-së citat: “Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian, për Konkurrencën”.

- Andaj për qartësuar çështjen tutje, Autoriteti ka kërkuar edhe ekspertizën e ekspertëve të projektit nga BE (Instrumenti i Para Anëtarësimit - IPA).

Përkitazi me kërkesën tonë, nga të njëjtët kemi pranuar “Notë Këshilluese Nr. 81” lidhur me Përjashtimet grupore nga ndalimi i përgjithshëm i marrëveshjeve anti-konkurrese.

Grupi i punës i cili ka qenë përgjegjës, për ta analizuar dhe vlerësuar, kërkesën për Përjashtim nga Ndalimi nga Marrëveshja Horizontale, për kompanitë e Sigurimeve, për tregun e produktit “Sigurimi i Produkteve Bujqësore”, paraqesim këto arsye pse “kërkesa” nuk plotëson kushtet për përjashtim, sipas Ligjit Nr. 03/L-229, plotësim ndryshimin e Ligji 04/L-226 dhe Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht, Udhëzimin Administrativ Nr.05/2017 për Përjashtimet Grupore të Marrëveshjeve në sektorin e Sigurimeve dhe Udhëzimi Administrativ për Përjashtim të Marrëveshjeve Horizontale Nr. 02/2017, si në vijim:

- Një marrëveshje për t’u përjashtuar nga Marrëveshja Horizontale, fillimisht duhet të përmbushen 4 kushte në mënyrë kumulative : *Efikasitetet, Ndarja e pjesës së drejtë për konsumatorët Domosdoshmëria, Mos eliminimi i konkurrencës.*
- Një marrëveshje mund të përjashtohet, vetëm nëse plotëson dhe i kalon kushtet, si më lartë. Gjithashtu, vlen të theksohet se për raste të tilla barra e provës bie mbi ndërmarrjet, të cilat dëshirojnë të përjashtohen nga marrëveshja, e që Autoriteti kërkon nga ndërmarrjet, të mbështesin pretendime të tilla me të dhëna dhe fakte të detajuara dhe bindëse dhe që pretendimet e përgjithshme se një marrëveshje do të ketë efekte pozitive.
- Për të vlerësuar nëse kjo marrëveshje për përjashtim plotëson kushtet ligjore, Autoriteti gjithashtu ka analizuar faktin se a e shtrembëron konkurrencën marrëveshja e kompanive për t’i caktuar rrjedhimisht fiksuar çmimet e policave të sigurimeve të produkteve bujqësore.
- Konstatojmë se një aktivitet i pretenduar nga palët shtrembëron konkurrencën, sepse caktimi i çmimeve, bie ndesh me nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, po ashtu kërkesa e palëve, lidhur me aktivitetin e pretenduar, është vlerësuar në *ex ante*, që nënkupton se palët pas lejimit nga ana e Autoritetit, do të dakordohen për kriteret dhe kushtet e marrëveshjes, e që si rezultat i saj do të jetë fiksimi i çmimit.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017, për përjashtimin në sektorin e sigurimeve, lejon vetëm marrëveshjet, që kanë të bëjnë me *shërbime të përbashkëta për llogaritjen e rreziqeve dhe studime të përbashkëta (listë shteruese)* mund të përjashtohen, e jo caktimi i çmimeve të përbashkëta.
- Gjithashtu, duhet theksuar se përfitimet nga Vendimi i Ministrisë së Bujqësisë për subvencionimin e premimeve të sigurimit nuk janë të njëjta me përfitimet e marrëveshjes

në fjalë dhe për rrjedhojë, nuk duhet të përfshihen në këtë vlerësim. Nuk ka asnjë argument që Ministria e Bujqësisë, kërkon nga Autoriteti, që të mbështesë sektorin dhe se një vendim i tillë mund të jetë i dobishëm. Megjithatë, nuk është e qartë se si një marrëveshje midis kompanive të sigurimit për të rregulluar premiumet e tyre mund të ndihmojë në arritjen e këtij qëllimi, ose çfarë përfitimesh mund të sjellë. Përfitimet duhet të rrjedhin në mënyrë specifike nga marrëveshja në fjalë. Aktualisht, ky lloj bashkëpunimi ndërmjet shoqërive të sigurimit do të çonte në një eliminim total të konkurrencës së çmimeve ndërmjet tyre, gjë që do të çonte në premiume më të larta se sa do të krijoheshin në kushte normale konkurruese. Kjo do të nënkuptonte gjithashtu shpenzime publike më të larta pasi që do të jepeshin subvencione nga një nivel mundësisht më i lartë, të gjitha kompanitë e sigurimeve kanë të njëjtin ri-sigurues.

Për nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë vendim të njoftohet:

Arkiva

Elsig sh.a

Eurosig sh.a

Publikohet në Gazetën Zyrtare

Të publikohet në Web faqe

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS



Nejme Bunaku - Isufi
Kryetare

()
Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

()
Nahje Osdautaj
Anëtare

()
Besim Stublla
Anëtar